

KASTRIOT GJIKA EKZILI SI FJALË ÇELËS NË INTERPRETIMIN E POEZISË SË FAN S. NOLIT

821.18-1.09

Rrethanat, mjedisi, veçanërisht mjedisi specifik në të cilin ndodhet a zhvillon veprimtarinë e vet shkrimtari i ndodhur për rrethana të gjithfarëshme në ekzil, janë me mjaft rëndësi edhe në interpretimin e veprës së tij. Exilforschung (= kërkimet në fushë të ekzilit) përbëjnë sot një fushë disiplinare specifike dhe të njohur botërisht dhe për të cilën kërkimi shkencor shfrytëzon edhe metodologji të reja, që përfshijnë edhe sociologjinë e letërsisë. Le të lejohe mi, më së pari, që në përpjekje për stabilizimin e terminologjisë së përdorur, të sjellim dy citime që i shërbejnë këtij qëllimi:

"Nëse është e vërtetë që çdo person të cilit, për arsye të ndryshme, i mohohet kthimi në shtëpi, duhet konsideruar azilant, gjithashtu duhen mbajtur parasysh një sërë ndryshimesh thelbësore mes azilantit, refugjatit, të shpërngulurve dhe emigrantëve. Ekzili zë fill nga praktika e dëbimit/ndalimit. Ekzili sjell me vete, besoj, një karakter të veçantë vetmie ..." (Eduard Said - "Në shenjë të ekzilit", 2008)

"Ajo që shkrimtari në ekzil ka të përbashkët me një emigrant ekonomik apo me një refugjat politik, është që si në njërin, edhe në tjetrin rast, një person ikën nga e keqja te më e mira. Në gjithë këtë, e vërtetë është që nga një tirani mund të ikësh vetëm duke u strehuar në një demokraci" (Josif Brodskij - "Nga ekzili", 1988)

Rasti që ne kemi zgjedhur, ai i shkrimtarit dhe intelektualit Fan Noli, besojmë se është shembull i vlefshëm për t'i interpretuar e shpjeguar disa dukuri të letërsisë së ekzilit, qoftë në kontekstin e letërsisë shqipe, qoftë edhe në një kontekst më të përgjithshëm.

I lindur në ngulimet shqiptare të Thrakisë, Fan Stilian Noli ishte pasardhës pikërisht i shtegtarëve që zgjedhën të linin trojet e tyre e të vendoseshin në këtë hapësirë mes dy kontinenteve, Europës e Azisë. Ai bart dukshëm shenjë fillestare të një paradigme mërgimi, të një "fatumi" prej ikanaku që s'i zënë këmbët dhé.

Shtegtimi i parë - në 1896 (14 vjeç) shkoi në Edërne (në Adrianopojën kozmopolite e heteroetnike) për të kryer gjimnazin.

Shtegtimi i dytë - në 1900 shkoi në Kostandinopojë (Stamboll) e më pas, në 1901 në Athinë.

Shtegtimi i tretë - në 1904 në Egjipt (Aleksandri), në Kajro e në Shibini me trupën shëtitëse teatrore.

Shtegtimi i katërt - në 1906, në moshën 24-vjeçare, në ShBA. Aty në vitin 1908 shugurohet prift ortodoks.

Deri në rikthimin e tij në ShBA në maj të 1915, ai ndërmoi udhëtime të vazhdueshme, në Europë (në lindje të saj në Rusi, Rumani, Bullgari, në 1911) pastaj edhe në Londër, në Trieste, në Zarë të Kroacisë, në Bukuresht të Rumanisë, përgjatë vitit 1912.

Në Shqipëri vjen për herë të parë në Vlorë, në 20 korrik 1913, në moshën 31-vjeçare, qëndron vetëm 2-3 ditë e më pas shkon në Durrës, në Trieste, në Vjenë, sërisht në Durrës e sërisht në Vjenë në shtator 1914. Siç e përmendëm më sipër, rikthehet në ShBA në maj 1915.

Më 28 shtator 1920 nis një tjetër shtegtim, më saktë rikthim, në Shqipëri. Nga ajo pritje disi e ftohtë në Vlorë në shtator të 1920 e deri të ai largim i trishtë e dramatik nga Durrësi në dhjetor 1924, në jetën e në karrierën e tij ndodhin një sërë ngjarjesh kulmore e tepër të rëndësishme jo vetëm për të personalisht, po për krejt historinë moderne të Shqipërisë. Mes Shqipërisë Italisë, Zvicrës, Gjermanisë etj., gjatë atyre katër viteve ai përjeton pothuaj gjithçka: kryetar i një partie, deputet, ministër i jashtëm, lider i opozicionit, frymëzues e udhëheqës i një kryengritje, kryeministër 200-ditësh, por edhe themelues e kryetar i Kishës Autoqefale Ortodokse, kryepeshkop i Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë etj.. Në përfundim të këtij apogjeu, me dështimin dhe rënien e qeverisë së tij, Noli merr rrugën e mërgimit politik. Ndoshta pikërisht kjo periudhë do të mund të quhet periudha e vërtetë e ekzilit të tij, që do të zgjasë, së paku sipas këtij koncepti, deri në 1932, pra plot 8 vite të gjata.

Më 13 janar të vitit 1925 Fan Noli merr trenin për në Vjenë, Aty e gjen njoftimi se kundërshtari i tij më i egër politik, Ahmet Zogu, tashmë në pushtet, e kishte dënuar me vdekje. Ato ditë ndodhi edhe vrasja në pusi, në një shesh të Barit, e Luigi Gurakuqit.

Në verë të 1926 e gjejmë në Berlin, por baza e qëndrimit të tij aso kohe ishte Vjena.

Me rastin e 28 nëntorit 1926 boton vjershën "Hymni i flamurit", si edhe dy elegjitë e famshme për Bajram Currin dhe për Luigi Gurakuqin.

Në nëntor të atij vitia shkon në një udhëtim festiv në Moskë, çka shënon një moment afrimi me bolshevizmin dhe me mjaft eksponentët të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, përfshi edhe disa figura bashkëpatriotësh shqiptarë.

1 shtatori 1928, dita e shpalljes së mbretit Zog, e gjen Fan Nolin në Gjenevë. Brenda asaj jave boton te "Liria Kombëtare" (organ i KÇN-së), poezinë satirike "Kënga e Monarkisë" (që më vonë do të njihet si "Kënga e Salep Sulltanit") dhe poezinë "Marshi i Barabait" (fillimisht e titulluar "Hosanna Baraba").

Në pranverë të vitit 1929, Noli do të shpërngulet nga Vjena në Berlin. Përvoja e Berlinit e sprovon atë si një luftëtar të vendosur kundër fashizmit, madje të afishuar publikisht. Kështu ai merr pjesë në si delegat dhe drejtues në Kongresin Ndërkombëtar Antifashist në Berlin, krah Hanri Barbysit. E po ashtu, në 21-27 korrik 1929 merr pjesë në Kongresin e Dytë të Lidhjes Antiimperialiste për Çlirim Kombëtar, si një nga 8 delegatët e Ballkanit (ndër 250 delegatë nga gjithë bota), përkrah A. Ajnshtajnit etj.

Në kapërcyell të viteve 1929 - 1930 mendimet e ndjenjat e tij i gjejmë të shprehura në një cikël vjershash, kulmi i poezisë noline: "Moisiu në mal", "Shën Pjetri në mangall", por edhe "Rent or Marathonmak".

Por poezia më e famshme dhe më emblematikepërsa i takon temës së ekzilit, "Anës lumenjve", u shkrua në maj të vitit 1930, kur ai lëvizte mes Berlinit dhe Hamburgut, mes lumenjve Elba dhe Spre. Poezia u botua vite më vonë në "Dielli" në 1943-në dhe më pas te "Albumi", në 1948-n. Thelbi i poezisë është vajtimi prej mërgimtari, i shtrënguar të endet dherave të botës, kudo përveç vendit të vet. Në vendin e gabuar (Out of place) jo rastësisht përkon me titullin e autobiografisë së Eduard Saidit, një nga emrat më eminentë në studimet për ekzilin (dhe jo vetëm). Të ndjerët në një vend "të huaj", "të gabuar" është një aspekt që karakterizon ekzistencën e atyre që janë shtrënguar të lenë vendin e tyre. Said reflekton mbi dy faktorë që e kanë shenjuar jetën e tij dhe me të cilat duhet patjetër të përballet në momentin në të cilin vendos ta "përkthejë" në gjuhën e shkrimtarisë. Faktorë që përziejnë gjuhë dhe vende të ndryshme dhe domethënëse për ata që i përshkojnë. Kjo përkatësi e shumfishtë gjuhësore, në rastin e Nolit tonë, është një nga faktorët më të rëndësishëm që e ka shenjuar krijimtarinë e tij.

Kështu zë fill edhe projekti letrar i Fan Nolit për t'i përmbledhur vjershat origjinale dhe shqipërimet poetike në një vëllim, me titullin e paramenduar "Tragjedia e kryqit".

Rikthehet në ShBA për një periudhë të shkurtër qëndrimi, në maj të vitit 1930.

Ftesës së Ahmet Zogut për të zënë "qoshen e merituar të përgatitur me kohë", e cila i erdhi në gusht 1930, Fan Noli iu përgjigj publikisht: "Më mirë i vdekur në syrgjyn e në rrogos, se i gjallë dhe i kapardisur në qoshen e bejlerëve".

Kthehet në Gjermani në janar 1931, ku bëhet objekt i kritikave të ashpra e madje sulmeve të ish-shokëve të KQ të KÇN-së, pas së cilave shkruan madje edhe një "Vetëkritikë".

Sërish një periudhë 6-mujore në ShBA, më pas në Hamburg të Gjermanisë.

Më 21 tetor 1932 mbërrin përfundimisht në ShBA, për të mos e kapërcyer më kurrë Atlantikun e për të mos e bërë më asnjëherë rrugën e kthimit në Evropë.

Kjo periudhë, 1924 - 1930, do të duhet parë si periudha e ekzilit të vërtetë, atij që i plotëson disa kushte specifike për t'u quajtur si i tillë, së paku, sipas tezave e koncepteve të një studiuesi teoretik të ekzilit dhe të letërsisë së ekzilit, siç është Eduard Said, me veprën e vet "Në shenjë të ekzilit".

Nëse poezia e parë origjinale e Nolit, "Fryn moj erë", datohet në 23 janar 1907 (ca ditë pasi ishte bërë 25 vjeç) dhe e fundit poezi origjinale në dorëshkrim, "Vdekja e Sulltanit" daton më 1 shkurt 1964, vetëm pak kohë para vdekjes së vet; në mes këtyre dy datave kemi një periudhë të gjatë kohore në të cilën Noli ndërmori dy herë "vrulle" krijimesh poetike. Së pari në vitet 20 të shekullit të kaluar (kur ai ishte 40-vjeçar) dhe së dyti në vitet 50 – 60, kur Noli ishte në pleqëri të thellë.

Kujdesi më i parë që ne duhet të bëjmë është që të mos e shohim këtë edukuri të ekzilit si një dukuri të shkëputur, sporadike dhe vetëm në rastin e F. Nolit apo vetëm për letërsinë shqipe. Në këtë rast inkuadrimi duhet bërë në atë valë ekzili nga Europa e totalitarizmave (Gjermania, Italia, Spanja, Franca e Vishi-së) në vitet midis dy Luftërave Botërore, drejt ShBA-ve. Viteve të fundit është shtuar, në raport me vitet e shkuara dhe falë një dokumentacioni arkivor më të detajuar e më të pasur, edhe çështja e kontaktit kulturor dhe shkencor me atdheun e ri, vështirësitë e refuzimi për t'u kthyer, etj.

Ekzili paraqet, sipas një tradite të gjatë historike dhe letrare, situatën ekzistenciale të të mërguarit a ikanakut dhe kjo çon në një zhvendosje të theksit: për ta thënë sipas W. Benjamin-it kemi kalimin nga Erfahrung i ekzilit (përvojë konkrete, kujtesë e transmetueshme) në Erlebnis (kujtesë e përjetuar, sekrete dhe e fragmentuar).

Së pari - kategoria e kohës dhe e hapësirës, siç ajo u modifikua nga ekzili evropian i periudhës midis dy Luftërave dhe nga karakteri thellësisht intelektual i tij: emigrimi i figurave autoritare të botës artistike, shkencore, akademike europiane, bëri që së bashku me njerëzit të emigronin, të zhvendoseshin gjetiu edhe dënimi moral dhe publik i botës dhe i regjimeve nga ku ata iknin. Kështu që interesimi historik për ngjitjen në pushtet, deri në atë absolut, të mbretit Zog, përkon me interesimin e posaçëm për ngjarjet e viteve 1920-24, që e paraprinë këtë ngjitje.

Me çfarë konkretisht lidhet veçanësisht, tipologjia e ekzilit evropian mes dy Luftërave drejt SHBA-ve? Sigurisht, me rolin e intelektualëve, të artistëve, të shkrimtarëve. Ky rol pati një vlerë të dyfishtë: nga njëra anë për aftësinë e tyre për t'i paraprirë krizës së qytetërimit të Europës nga ku ata iknin. Për ta flitet si "lajmëtarë të zjarrit që po ndizej". Element tjetër për t'u nënvizuar është që ata emigrojnë nga një demokraci eksperimentale, latente, në një tjetër demokraci (atë amerikane), tek e cila ata dallojnë risitë dhe ndryshimet, por edhe rreziqet e boshllëqet. Dhe në këtë vend përtej oqeanit, përkundrajt triumfit fitimtar të regjimit që e përzuri, ikanaku paralajmëron mbrojtjen që ai i bën një Europe tjetër, asaj për të cilën personalisht do të luftojë gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Ekzili përjetohet si një "çlirim" - jep një shpjegim shkrimtarja çeke Vera Linhartova -qoftë kjo si një zgjedhje që përfshin edhe vetë gjuhën. Shkrimtari nuk është rob i një gjuhe të vetme"

Sërish Eduard Saidi jep një mësim më të qartë: "Kultura e Perëndimit modern është në një shkallë të gjerë produkt i azilantëve, emigrantëve, refugjatëve. Në Shtetet e Bashkuara, p.sh., mendimi akademik,

intelektual dhe estetik është ai që është, në rend të parë falë atyre që u larguan nga fashizmi, nga komunizmi a nga regjimet e tjera - pasojë kjo pak a shumë imediate, por reale, e shtypjes dhe e përjashtimit masiv të desidentëve. Kjo e ka çuar George Steiner-in të hedhë tezën mëse të bazuar, sipas së cilës një zhanër i tërë i letërsisë perëndimore të shekullit XX do të duhej të konsiderohej "ekstra territoriale": një letërsi prej ekzili dhe mbi ekzilin, që e shenjon këtë kohë si "koha e refugjatëve". (Eduard Said)

Josif Brodskij - shkrimtar rus i ikur nga vendi i tij në 1972 dhe i strehuar në SHBA, i cili në ligjëratën e tij me titull "Statusi që e quajmë ekzil", shpreh: "Për një njeri që ushtron zanatin tim, statusi që e cilësojmë si ekzil është para së gjithash, një ngjarje gjuhësore: një shkrimtar ikanakndjehet i sulmuar dhe mbrohet, tërhiqet brenda gjuhës së mëmës. Ajo që ishte fillimisht shpatë për të, tani bëhet mburojë. Ajo që për të ishte fillimisht një lidhje private, intime me gjuhën, në ekzil shndërrohet në destin - edhe më parë se të shndërrohet në një obsesion a një detyrë".

Gjendja e azilantit shndërrohet në një shkas për të zhvilluar një refleksion mbi një mënyrë të caktuar të të bërit kritikë letrare dhe jo vetëm (edhe kritikën e shoqërisë p.sh.), kritikë kjo e e angazhuar, e shqetësuar dhe jo lineare, e hapur ndaj dyshimeve dhe ndaj një shumësie perspektivash.

Sërish tek Eduard Saidi e gjejmë një përkufizim që i rri fort për shtat Nolit: "Pjesa më e madhe e njerëzve jeton në vetëdijen e një kulture, të një gjuhe, të një mjedisi e të një shtëpie. Azilantët, përndryshe, kanë vetëdijen e ekzistencës së më së paku dy nga këto kushtëzime. Dhe një shumësi e tillë sjell nga ana e vetëdijen e ekzistencës së përmasave simultane, një vetëdije kjo që është, me një term të huazuar nga muzika, **kontrapuntistike**."

Shkrimtarët (dhe kritikët) e kanë parë ekzilin si një shtysë krijuese (sado të dhimbshme) që, ndoshta, në njëfarë mase, arrin ta zbusë atë dhembje, pikërisht në momentin që ajo "përkthehet" në fjalën e shkruar.

Letërsia mbetet, potencialisht, vendi ku mund të kërkojmë strehim, ku hierarkitë zhduken dhe kufijtë asgjësohen. Ku mund të rrëfesh, të rrëfesh për veten, për përvojat vetjake, duke mësuar t'i pranosh e t'i përbrendësosh. Të kujtosh e të rindërtosh, edhe pse vetëm në një formë letrare, është një veprimtari e vështirë, por edhe vetëpastruese për atë që e praktikon.

Po t'i referohemi Kutelit, mbledhësit, botuesit e kritikut të parë të poezisë së Nolit, poezia e Nolit është "*një poezi personale*", me burimin në ngjarjet politike që "*i pat rrojtur e vojtur ai vetë*" pas qershorit 1924. Çka na duket e gjetur është kjo fjali që e hasim në këtë analizë: "*Fan Noli bëhet poet, pa i thënë vetes poet*".

Na duket gjithashtu me mjaft vend përcaktimi që kritiku i ri, Arshi Pipa, i bënte, nga njera anë Gj. Fishtës, si "*konservator, tradicional, shqiptar, malsuer fanatik qind për qind*", nga ana tjetër F. Nolit si "*shqiptar evropian, revolucionar*". Arshi Pipa e sheh Fan Nolin si një personalitet të dyzuar mes Lindjes e Perëndimit, me një shtysë instiktive drejt botës lindore, por i pajisur me një arsye të qartë që e shtynte drejt Perëndimit, atij "*ma të largtit, ma modernit: Amerikës*". Më përmbledhtaz, Noli sipas Pipës ishte ma tepër "*centrifugal*", çka shenjon fort edhe veprën e tij, pasi edhe në poezi ai ishte "*nji shtegtar*".

LITERATURA

BRODSKIJ Josif - "Dall'esilio" - Adelphi - Milano 1988

GJIKA Kastriot - "Çështje të receptimit historik të poezisë së Nolit" - në "Fan S. Noli në 130 vjetorin e lindjes" - Korçë 2012

JORGAQI Nasho - "Jeta e Fan S. Nolit" - 2 vëllime - OMBRA GVG - Tiranë 2005

KUTELI Mitrush - "Poeti Fan Noli – vështrim panoramik" botuar në "Fan S. NOLI - Mall e brengë – vjersha", Tiranë 1943

NOLI S. Fan - Vepra 1 - Tiranë 1987

PIPA Arshi - "Shënime kritike mbi librin Fan S.Noli "Mall e brengë", me një vështrim kritik prej Mitrush Kutelit" - "Kritika", nr 1, mars, 1944

SAID Edward - "Nel segno dell'esilio" - Feltrinelli - Milano 2008

SAID Edward - "Sempre nel posto sbagliato. Autobiografia" - Feltrinelli - Milano 2000